

VENDIM
Nr. 519, datë 20.9.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT
DHE UJIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 738, datë 13.12.2017; nr. 820, datë 26.12.2024; nr. 78, datë 5.2.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, si autoritet kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe si organ qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë anëtar;*
- ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe anëtar;*
Inovacionit
- ministrin e Drejtësisë anëtar;*
- ministrin e Turizmit dhe Mjedisit anëtar;*
- ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit anëtar;*
Rural
- ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe anëtar;*
Klimën e Biznesit
- ministrin e Mbrojtjes anëtar;*
- ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes anëtar;*
Sociale
- ministrin e Financave anëtar;*
- drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së anëtar dhe*
Zhvillimit të Territorit sekretar.

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri apo ministri anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, përkatësisht, me të drejtë vote:

- personi i autorizuar nga Kryeministri, i cili kryeson mbledhjen;
- zëvendësministri, përfaqësues i ministrit në mungesë.

3. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

5. Sekretariati teknik i KKTU-së zbaton vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, të cilat na dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar. Vendimet nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretarit të KKTU-së. Vendimet, pasi nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

Në rastin e zbatimit të vendimeve, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, sekretariati teknik koordinon veprimet me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet për dhënie lejeje apo autorizimi, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet, pasi nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe, kur është rasti, edhe nga sekretari i KKTU-së, hyjnë në fuqi menjëherë.

6. Vendimi nr. 1097, datë 28.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi